



Datë: 19.06.2015,
Prishtinë

Kushtet administrative për Licencim të Operatorëve Ekonomik për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të pajisjeve elektronike fiskale

Operatorët ekonomik që aplikojnë për Licencim, bashkë me Shprehjen e Interesit, duhet të dorëzojnë përveç tjerash dokumentet në vijim:

1. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare (ARBK) dhe Çertifikatën e Numrit Fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).
2. Vërtetim nga Gjykata Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike me të cilin vërtetohet se operatori ekonomik nuk është në procedurë likuidimi ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë. Ky vërtetim kërkohet të jetë origjinal, i lëshuar jo më herët se 60 ditë nga data e dorëzimit të ofertës.
3. Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, se operatori ekonomik në fjalë nuk ka obligime tatimore.
4. Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga ana e prodhuesit për të drejtën e shitjes së PEF-ve (Pajisjet Elektronike Fiskale). Autorizimi kërkohet të ofrohet në origjinal nga prodhuesi i specifikuar për këtë projekt. Autorizimi duhet të ketë informatat kontaktuese të prodhuesit i cili ka lëshuar autorizimin.
5. Operatori ekonomik duhet ta dorëzojë garancionin për furnizim me pjesë rezervë të PEF-ve, për më së paku pesë vite pas shitjes së këtyre pajisjeve. Ky garacion duhet të jetë origjinal, i lëshuar nga prodhuesi për këtë projekt.
6. Qarkullimi i deklaruar për dy vite e fundit të jetë mbi 1 milion (një milion) Euro. Qarkullimi kërkohet të dëshmohet me dokumentacion të paraparë me Ligj.
7. Operatori ekonomik duhet të disponoj me qendër shërbimi dhe servisimi për këto pajisje, në Kosovë, me të paktën 80 m² hapësirë pune. Ky kusht duhet të përmbushet para lëshimit të vendimit për licencim të operatorit ekonomik.
8. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi valide nga prodhuesi i Pajisjeve Elektronike Fiskale se ky i fundit ka ofruar (shitur) pajisje të njëjta të paktën në një vend (shtet) tjetër në tri vitet e fundit.
9. Nga operatori ekonomik kërkohet një Sigurim i Ofertës në vlerë prej 5, 000 (pesë mijë) €, të lëshuar nga ndonjë prej bankave komerciale apo forma tjera të garantimit të pranueshëm.

Vlefshmëria e sigurimit të ofertës duhet të jetë 60 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të ofertës.

10. Pas përfundimit të procedurave të licencimit, dhe para nënshkrimit të kontratës me ATK-në, operatori ekonomik të garantoj punën me një garanci bankare, apo forma tjera të garantimit të pranueshëm sipas kriterëve të poshtë shënuara me vlera prej:

- 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë Euro) prej 0 - 300 pajisje,
- 100,000.00 € (njëqind mijë Euro) prej 301 - 500 pajisje dhe
- 200,000.00 € (dyqind mijë Euro) mbi 500 pajisje.

Në rast të skadimit të afatit të garancionit, i njëjti duhet të filloj procedurat e ripërtëritjes 5 ditë para skadimit të tij, në të kundërtën licenca do të pezullohet. Ky garacion do të shfrytëzohet nga ATK-ja, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 të lëshuar nga MEF-i.

11. Nëse ofertuesi është grup i operatorëve ekonomik (konzercium) i themeluar sipas legjislacionit në fuqi, të gjithë anëtarët e grupit, individualisht, duhet t'i plotësojnë kushtet që janë të cekura në pikat 1, 2, dhe 3 të këtyre kushteve administrative.

12. Në rast të ofertimit nga grup operatorësh ekonomik, kërkohet kopja e noterizuar e marrëveshjes në mes të operatorëve (anëtarëve të konserciumit).

Komisioni për Autorizimin e Operatorëve Ekonomik